



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 35 Akti

Nr. 55 Vendimi

Tiranë, më 31.07.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari
Xhensila Pine
Etleđa Çiftja

Kryesuese
Anëtare
Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, më datë 27.07.2018, ora 11:00, në katin e dytë, pranë Pallatit të Kongreseve zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Rreshka**, prokuror, drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni D, Ç dhe Ë i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit Dritan Rreshka, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT ÇËSHTJES

1. Z. Dritan Rreshka është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.
2. Në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë se z. Dritan Rreshka ishte kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017, me trup gjykues nr. 4, të përbërë nga:

Xhensila Pine	Komisionere;
Valbona Sanxhaktari	Komisionere;
Etleda Çiftja	Relatore.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme (këtu e më poshtë referuar si “GPPP”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues nr. 4, i shortuar më 30.11.2017 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “Komisioni”), me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; (ii) të caktojë kryesuese të trupës znj. Valbona Sanxhaktari; dhe (iii) të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Më datë 06.07.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të

interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta

6. Më datë 09.07.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.
7. Më datë 11.07.2018, subjekti rivlerësimit bëri kërkesë për njohje me dosjen dhe marrjen e një kopjeje të dokumenteve të dosjes, kërkesë e cila iu pranua po të njëjtën ditë nga Komisioni.
8. Subjekti i rivlerësimit, më datë 12.07.2018, me anë të postës elektronike, kërkoi zgjatje të afatit të procedurës për paraqitjen e shpjegimeve apo provave në lidhje me rezultatet e hetimit për një kohë prej 20 ditësh, si dhe nëse shpjegimet mund të dërgoheshin në vazhdimësi, kërkesë e cila iu pranua nga Komisioni, duke i dhënë subjektit dhe katër ditë shtesë, deri më 27.07.2018.
9. Më datë 13.07.2018, trupi gjykues nr. 4, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 27.07.2018, ora 15:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.
10. Më datë 25.07.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat. Komisioni administroi provat dhe shpjegimet e subjektit, që u dërguan me anë të postës elektronike nga data 13 korrik deri më 25 korrik, sipas kërkesës së subjektit.
11. Më datë 25.07.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi të njihej me rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale. Komisioni nuk e pranoi kërkesën, pasi provat e administruara nga ana e Komisionit për komponentin e pasurisë arritën nivelin e provueshmërisë për të kaluar barrën e provës dhe vendimi mund të merret bazuar vetëm në një komponent, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon se: *“Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, si dhe sipas vendimit nr. 3, datë 17.07.2018, të Kolegjit të Apelimit, pika 16, e seksionit III.1 të këtij vendimi.
12. Në po të njëjtën datë, 25.07.2018, subjekti i rivlerësimit solli shpjegimet përfundimtare. Në të njëjtën kohë, ai kërkoi të mos merret parasysh raporti i dorëzuar nga ana e ILDKPKI-së, pasi ai ka qenë drejtues i njësisë së posaçme të hetimit të korrupsionit dhe pasurisë pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Komisioni nuk e pranoi këtë kërkesë, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk solli prova për të vërtetuar pretendimin e tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*.
13. Bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, Komisioni vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, *vetëm* mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë, pa përfshirë në vendim kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.
14. Për shmangien e çdo keqinterpretimi, ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Dritan Rreshka merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

II. SEANCA DËGJIMORE

Më datë 27.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë dhe i shoqëruar nga avokati i tij, z. Arben Rakipi. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Seanca dëgjimore e datës 27.07.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 31.07.2018, për shpalljen e vendimit. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe depozitoi shpjegimet e tij me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2017, raportin

¹ 41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, ku konstatohet se:

- a. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c. ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. ka kryer deklaratim të rremë;
- e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 13.07.2018 e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga ana e Komisionit është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur, që u identifikuan nga hetimi administrativ.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” të 2017-ës, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. **Kati përdhe dhe i dytë i një shtëpie private**, ndodhur në Rr. “****”/****. Sipërfaqja e katit përdhe 131 m² dhe kati i dytë 166 m². Burimi i krijimit: i) Emigrimi në Greqi; ii) puna pranë “CRS Albania”; dhe iii) Kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.2004, me vlerë 18.000 euro.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- i. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 21.10.2016, për apartament me sipërfaqe 166.9 m²;
- ii. Kartelë pasurie për sipërfaqen 166.9 m², me datë regjistrimi 21.10.2016 ;
- iii. Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 26.03.2012, për pasurinë me sipërfaqe 131.4 m², kati përdhe në godinën pesëkatëshe dhe kartelë pasurie për sip. 131 m², regjistruar më datë 21.11.2014 me leje legalizimi.

Lidhur me burimin, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- i. Kontratë kredie dhe vënie në hipotekë të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.2004, me “NBG Bank”, në shumën 18.000 euro.

1.1. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht

a. Të përgjithshme

- 1.1.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se ka në pronësi katin përdhe dhe të dytë të një shtëpie private, me vlerë ndërtimi 2.800.000 lekë. Ai ka deklaruar se e ka ndërtuar me të ardhurat nga emigrimi në Greqi, nga të ardhurat nga puna pranë “CRS Albania”; dhe kredia e marrë pranë “NBG Bank” me anë të kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.2004, me vlerë 18.000 euro.
- 1.1.2. Subjekti i rivlerësimit, për vlerën e ndërtimit sipas paragrafit më lart, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues ligjor (*preventiv punimesh, situacion punimesh, akt kolaudimi, etj.*) për të vërtetuar këtë vlerë për ndërtimin e shtëpisë së banimit.
- 1.1.3. Nga hetimi i kryer në lidhje me këtë pasuri, Komisionit i rezulton se kati përdhe dhe i dytë është pjesë përbërëse e një godine 5-katëshe në pronësi të subjektit të rivlerësimit, e cila është fituar me anë të lejes së legalizimit nr. ***, datë 20.2.2012, për godinë banimi 5-katëshe, ZK ***, nr. pasurie ***, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 263.3 m², sipërfaqe ndërtimi 131.4 m², sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 743 m², numri i kateve mbi tokë 5 (pesë); planimetri të kateve përdhe, i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt me posedues Dritan Rreshka.
- 1.1.4. Më tej rezulton se kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në vitin 2012 në pronësi të subjektit të rivlerësimit, si: i) truall me sipërfaqe 293 m² në ZK***, vol. ***, fq. ***; mbi këtë truall është regjistruar godinë banimi (leje legalizimi) me këto apartamente; ii) apartament me sipërfaqe 131.4 m², zona kadastrale ***, vol. ***, fq. ***; iii) apartament me sipërfaqe 166.9 m², zona kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, (dupleks, bashkim i dy apartamenteve fq. *** dhe fq. ***, kati i dytë me sip. 166.9 m² dhe kati i tretë me sip. 166.9 m²; sip. totale 333.8 m²); iv) pasuri e transkriptuar: apartament me sipërfaqe 166.9 m², zona kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, dhe apartament me sipërfaqe 110.9 m², zona kadastrale ***, vol. ***, fq. ***.
- 1.1.5. Nga hetimi Komisioni konstatoi gjithashtu se, pasi subjekti regjistroi godinën 5-katëshe, ia dhuron më datë 03.04.2012 vëllait B. Rr katin e parë me sipërfaqe 166.9 m² dhe më datë 10.1.2017 i dhuron atij apartamentin nr. ***, me sipërfaqe 110.9 m², nga kjo godinë.
- 1.1.6. Më tej, Komisionit i rezultoi se më datë 21.10.2016, subjekti bashkon katin e dytë dhe të tretë me sipërfaqe totale 333.8 m², dhe e gjithë kjo tashmë emërtohet dubleks, e rivlerësuar për shumën 10.462.550 lekë.

b. Në lidhje me kohën e ndërtimit të këtij objekti 5-katësh

- 1.1.7. Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit deklaron se objekti godinë banimi kati përdhe dhe kati i dytë është ndërtuar në vitet 2003 dhe mes vitit 2004.
- 1.1.8. Në përgjigje të pyetësorit shtesë gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit deklaron se ndërtimi ka filluar në janar 2004 dhe ka vazhduar deri në qershor 2004.
- 1.1.9. Më datë 15.03.2012, pasuria godinë banimi 5-katëshe është regjistruar në ZVRPP në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” deklaron se posedon një godinë me 3(tre) kate banimi.
- 1.1.10. Në deklaratën vjetore të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkim pasurie të katit të tretë me atë të dytë, të emërtuar apartament dupleks.
- 1.1.11. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat vjetore të vitit 2009 deri në vitin 2016 përfundimin dhe vlerën e investuar në katin e tretë.

c. Në lidhje me fillimin e ndërtimit të katit përdhe, të parë dhe të dytë

- 1.1.12. Në vetëdeklarimin për legalizim të datës 21.03.2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ndërtimi ka filluar në muajin tetor të vitit 2003.
- 1.1.13. Në deklaratën e vjetore të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “Shtëpi private banimi dykatëshe (në proces legalizimi), me vlerë 2.500.000 lekë”, ndërtuar gjatë 2004.
- 1.1.14. Në përgjigjet e pyetësorit shtesë të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit deklaroi se arredimi/mobilimi i shtëpisë është bërë gjatë viteve 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007.
- 1.1.15. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 08.03.2018 gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se fillimi i punimeve për ndërtimin e shtëpisë është muaji janar 2004 deri në muajin qershor të vitit 2004, ku janë ndërtuar kati përdhes, kati i parë dhe kati i dytë.

d. Në lidhje me vlerën e deklaruar të ndërtimit të këtij objekti 5-katësh

- 1.1.16. Në deklaratën “Vetting” të 2017-ës dhe deklaratat periodike 2003, 2004, 2009, 2012, subjekti deklaroi se vlera e ndërtimit në total është 3.100.000 lekë (2.500.000 lekë + 600 000 lekë) për të gjithë godinën 5-katëshe, por pa paraqitur asnjë dokumentacion justifikues si situacion punimesh apo preventiv.

e. Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin

- 1.1.17. Subjekti i rivlerësimit ka dërguar si dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat nga emigracioni në Greqi, në shumën 2.500.000 lekë, që kanë shërbyer si burim për ndërtimin e katit përdhe, të parë dhe të dytë, si më poshtë:
 - dokument i lejes së lëshuar nga Policia në Naxos, Greqi, në momentin e legalizimit që bëri ky shtet për refugjatët, në emrin e tij, Dritan Rreshka;
 - pasaportë me nr. 0497515, datë 09.01.1998, në emër të Dritan Rreshkës, ku pasqyrohet kthimi nga Greqia në tetor 1998;
 - Vërtetimi i “Raiffeisen Bank”, datë 22.01.2016, si edhe vërtetimi po i “Raiffesien Bank” nr. ***, datë 10.07.2018, që konfirmon se Dritan M. Rreshka ka çelur një depozitë kursimi në ish-Bankën e Kursimeve më datë 23.10.1998, me afat tremujor, në shumën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.
- 1.1.18. Subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi nga “NBG Bank” në shumën prej 18.000 eurosh më datë 23.03.2004, për blerjen e një apartamenti me adresë në Rr. “****”, Tiranë.
- 1.1.19. Nga dokumentacioni i dërguar nga “NBG Bank”, nuk identifikohet se kujt i është transferuar shuma e kredisë në vlerën 18.000 euro.

1.2. Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimit të të ardhurave, administroi provat si më poshtë:

- 1.2.1 Deklarimet e kryera nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur pranë ILDKPKI-së (dërguar nga ana e ILDKPKI-së me anë të shkresës nr. *** prot., datë 17.11.2017).
- 1.2.2 Raportin e arsyetuar nga ana e ILDKPKI-së në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 (dërguar në Komision me shkresës nr. *** prot., datë 17.11.2017).
- 1.2.3 Dokumentet që provojnë se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, në emër të tij, një godinës 5-katëshe².

² Me kartelë pronësie për pasuri me nr. ***, ZK ***, vol. ***, fq. ***, truall me sipërfaqe 293 m², mbi të cilin është ndërtuar godina e banimit me 5 (pesë) kate, me leje legalizimi nr. ***, datë 20.2.2012; kati përdhe = 131.4 m²; kati i parë = 166.9 m²; kati i dytë = 166.9 m²; kati i tretë =

- 1.2.4 Dokumentet që provojnë se subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar një shtëpi 5-katëshe, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve, më datë 21.03.2005, (sipas shkresës me nr. ***, datë 28.12.2017, ardhur nga ALUIZNI).
- 1.2.5 Dokumentet që provojnë se subjekti i rivlerësimit i ka dhuruar dy kate banimi vëllait të tij. Z. B. Rr, njërin në vitin 2012 dhe tjetrin në janar 2017, marrë si dokumente me anë të shkresës nga Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtshme.
- 1.2.6 Deklaratën “Vetting” dhe dokumente bashkëlidhur që provojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues, preventiv punimesh apo situacion që të provojë punimet e kryera.
- 1.2.7 Deklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike gjatë hetimit, të dërguara me *e-mail*-in e datës 26.12.2017, *e-mail*-in e datës 08.03.2018, *e-mail*-in e datës 13.07.2018 deri më 26.07.2018, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore të datës 27.07.2018.
- 1.2.8 Leje legalizimi në emër të subjektit të rivlerësimit nr. ***, datë 20.2.2012, e cila konfirmon se godina banimit është 5-katëshe, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 263.3 m², sipërfaqe ndërtimi 131.4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 743 m².
- 1.2.9 Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, me nr. ***, datë 10.5.2017, dërguar ILDKPKI-së.

1.3. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dërguar deri më datë 25.07.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

1.3.1 Në lidhje me fillimit të ndërtimit të katit përdhe, të parë dhe të dytë

Sipas subjektit të rivlerësimit, fillimi i punimeve në kuptimin e strukturës së ndërtesës, duke filluar me themele dhe blinda betoni dhe dalja në sipërfaqe të sheshit ka nisur në muajin janar 2004 dhe ka vazhduar deri në muajin qershor të vitit 2004, kur janë ndërtuar kati përdhes, kati i parë dhe kati i dytë dhe punimet janë ndërprerë në kolonat e katit të dytë (të tretë, duke përfshirë katin përdhes), vërtetuar kjo me lejen e punimeve (Bashkia Tiranë) nr. *** prot., datë 23.06.2004, për furnizimin me ujë të objektit 3-katësh.

1.3.2 Në lidhje me burimin e të ardhurave nga emigracioni në Greqi

Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se si burim krijimi për këtë ndërtesë ka shërbyer shuma prej 2.8 milionë lekësh, si të ardhura nga emigracioni në Greqi. Për të justifikuar të ardhurat nga emigracioni ka dokumentin origjinal të lejes së punës të lëshuar nga autoritetet policore greke, pasaportën e tij të vjetër me nr. ***, lëshuar më datë 09.01.1998, ku pasqyrohet kthimi ose hyrja në Shqipëri nga shteti grek më datë 12.10.1998, si edhe vërtetimin e datës 22.01.2016 të lëshuar nga “Raiffesien Bank” sh. a., sipas të cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit kishte çelur një depozitë kursimi në ish-Bankën e Kursimeve më datë 23.10.1998 me nr. depozite ***, me afat tremujor, në shumën 1.600.000 (një milionë gjashtëqind mijë) lekë.

1.3.3 Në lidhje me faktin se pse leja e legalizimit dhe regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë është regjistruar vetëm në emër të tij dhe arsyet se pse nuk është deklaruar kjo e drejtë reale në deklarimet vjetore të ILDKPKI-së

166.9 m²; kati i katërt = 110.9 m². Data e regjistrimit 21.11.2014, në emër të Dritan Rreshkës, marrë nga ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. *** prot. datë 04.01.2017 (*gabim*, 2018) dhe marrë nga Komisioni me nr. *** prot., datë 05.01.2018.

Subjekti i rivlerësimit shprehet se objekti është vetëdeklaruar për legalizim në emër të tij për shkak të marrëdhënies së truallit me objektin informal. Një nga komponentët ose elementet përbërëse të vetëdeklarimit është edhe pronësia e parcelës ndërtimore mbi të cilën është ndërtuar objekti informal. Viti 2012 nuk përfaqëson fillimin e legalizimit të banesës, por përfundimin e këtij procesi, që ka filluar që më datë 21.03.2005, dhe është deklaruar që në formularin e deklarimit të pasurisë së vitit 2004 të depozituar pranë ILDKPKI-së më datë 29.03.2005, fillimisht të dy kateve dhe më pas të katit shtesë të ndërtuar në vitin 2009 dhe të pasqyruar në formularin e deklarimit të vitit 2009.

Më tej, ai shpjegon se *de jure* ka qenë ai pronar i të gjithë godinës, kurse *de facto* ka qenë vëllai i tij (gëzues dhe posedues) i katit të parë të banesës që prej gjysmës së parë të vitit 2004, si edhe i katit të katërt që prej gjashtëmujorit të parë të vitit 2009.

Subjekti i rivlerësimit shprehet se përfundimi i procesit të legalizimit (ka zgjatur 7 vjet) në vitin 2012 nuk ka sjellë rritje apo shtim të pasurisë së tij në kuptim të ligjit për deklarimin e pasurisë, por thjesht formalizim të pasurisë ekzistuese prej 3-katësh të deklaruar më parë (sipas ligjit, deklarimi i pasurive të paluajtshme bëhet edhe nëse ato nuk janë regjistruar pranë ZVRPP-së përkatëse).

Subjekti deklaron se nuk është leja e legalizimit dokumenti që tregon pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme, por vërtetimet e lëshuara nga ZVRPP-ja Tiranë, të cilat përcaktojnë pronësinë mbi këto pasuri. Subjekti shprehet se gjithmonë ka deklaruar pjesën takuese tijën, atë që ka qenë në posedimin, gëzimin dhe më pas disponimin e tij. Këtë detyrim e ka plotësuar në zbatim të detyrimeve ligjore të përmendura më sipër, sipas të cilave deklarimi i pasurive të paluajtshme bëhet edhe nëse ato nuk janë të regjistruara pranë ZVRPP-së përkatëse. Dy katet e ndërtuara me kontributin financiar të vëllait nuk kanë përbërë asnjëherë pakësim ose shtim të pasurisë së tij. Këto pasuri nuk janë krijuar në vitin 2012, por në vitin 2004 dhe në vitin 2009 dhe vëllai i tij, z. B. Rr, nuk ka qenë as subjekt për të cilin ai duhej të deklaronte dhe pasuritë e tij rrjedhin nga kontributi i tij financiar. Mbi këto pasuri subjekti i rivlerësimit shpjegoi se nuk ka pasur ndonjë të drejtë reale.

1.3.4 Lidhur me kostot e ndërtimit dhe përlllogaritjen e tyre nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se nuk ishte dakord me metodologjinë e përdorur sepse vlerësimi i kostos reale të investimit për ndërtimet informale nuk mund të bëhet duke përdorur referencat e kostos mesatare të ndërtimit sipas udhëzimeve ndër vite të Entit Kombëtar të Banesave.

1.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.4.1 Komisioni, duke pasur parasysh faktet e dala nga hetimi, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ligjin e zbatueshëm, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për arsye se:

Në lidhje me mosdeklarimin e fillimit të ndërtimit, fshehjes së 2 kateve shtesë të banimit

1.4.2 Subjekti ka fshehur fillimin e ndërtimit të shtëpisë, respektivisht katit përdhe dhe të dytë në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Referuar ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, subjekti duhej të kishte deklaruar fillimin e ndërtimit në qershor 2003, siç dhe

vërtetohet nga dokumentacioni i depozituar nga ALUIZNI, në formularin e vetëdeklarimit të subjektit.

- 1.4.3 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë pasi rezultoi të ketë fshehur 2 kate të banimit të godinës 5-katëshe, gjatë deklarimit të tij në vitin 2012. Sipas dokumentacionit provues nga ALUIZNI dhe ZVRPP-ja Tiranë, subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, *de jure* figuron pronar i të 5-ta kateve të banimit, fakt ky që përputhet me shpjegimet e tij përfundimtare të depozituara pranë Komisionit.
- 1.4.4 Sipas dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë dhe ALUIZNI, deri në vitin 2012, ai ka qenë pronar dhe posedues i vetëm i kësaj godine 5-katëshe. Përsa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte të 5-ta katet e banesës sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë”, i ndryshuar.
- 1.4.5 Më tej, subjekti i rivlerësimit shpjegon se *objekti është vetëdeklaruar nga ana e tij vetëm për sa i përket finalizimit të procedurës së legalizimit për shkak se ai ka qenë në cilësinë e pronarit të parcelës ndërtimore ku është ndërtuar objekti informal, duke lehtësuar procedurën e finalizimit të legalizimit në aspektin e kalimit të pronësisë, moskryerjes së pagesës lidhur me parcelën ndërtimore etj.*, pra arsyet e vetëdeklarimit kanë qenë lehtësirat që ai vetë do të kishte në procesin e legalizimit. Komisioni çmon se këto lehtësira, që i kanë shërbyer subjektit të rivlerësimit, nuk përbëjnë shkak ose justifikim për deklarim të rremë ose fshehje të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
- 1.4.6 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se kishte marrëveshjeve të pashkruara dhe verbale me familjen dhe vëllain, që katin e parë do ta mbante vëllai dhe katin e katërt gjithashtu, këto qëllime, edhe pse jo të shkruara, duhej të ishin deklaruar që në vitin 2012, kur ai është bërë pronar i një godine 5-katëshe.
- 1.4.7 Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit se *nuk është leja e legalizimit nuk është dokumenti që tregon pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme, por vërtetimet e lëshuara nga ZVRPP-ja Tiranë, të cilat përcaktojnë pronësinë mbi këto pasuri*, nuk qëndron pasi kjo bie ndesh me faktin e dalë nga hetimi administrativ, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit në datë 19.04.2012, i ka dhuruar vëllait, z. B. Rr, një apartament me sipërfaqe 166.9 m².
- 1.4.8 Nëse subjekti i rivlerësimit nuk do të ishte pronar, si është e mundur të bëhej ky dhurim dhe më tej të regjistrohej pranë ZVRPP-së Tiranë. Për më shumë në lidhje me qenien pronar apo jo në vitin 2012, leja e legalizimit sipas ligjit është dokument bazë për regjistrimin e tij në ZRPP, dhe ky regjistrim në fakt ka efekt deklarativ/njohës për palët e treta, por nuk është regjistri në ZVRPP që të bën pronar.
- 1.4.9 Si konkluzion, në lidhje me datën e fillimit të ndërtimit, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm se kur ishte data e fillimit të ndërtimit të godinës 5-katëshe. I vetmi fakt i vërtetuar nga subjekti është mbarimi i ndërtimit, i cili provohet me anë të lejes së legalizimit në emër të subjektit të rivlerësimit, me nr. ***, datë 20.02.2012.

Në lidhje me vlerën e ndërtimit të godinës 5-katëshe

- 1.4.10 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë të vlerës së ndërtimit të godinës 5-katëshe në deklaratën “Vetting” 2017, vërtetuar kjo me (i) mosparaqitjen e dokumentacionit justifikues, si preventive punimesh, situacion për ndërtimin e kësaj banese 5-katëshe; (ii) duke krijuar paqartësi në punimet që janë kryer në këtë godinë 5-katëshe; dhe (iii) thënie kontraktore në lidhje me burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj banese.
- 1.4.11 Në lidhje me mungesën e dokumentacionit justifikues, si preventive punimesh apo situacion, Komisioni çmon se për të vërtetuar sipërfaqen e ndërtimit, materialet e përdorura, për efekt analize të kostos dhe investimit të kësaj godine duhet të merren në konsideratë: (i) leja e legalizimit nr. ***, datë 20.02.2012, që përcakton se sipërfaqja totale e ndërtimit për banim është 743 m² dhe numri i kateve është 5 (pesë); (ii) akti i ekspertimit

i depozituar në dosjen e ALUIZNI-t i cili në germën “A” “Të përgjithshme”, specifikon se: “Objekti 4- katësh plus bodrum është ndërtuar me konstruksion mbajtës, me mure tulle mbi themele të vazhduara me beton arme. Trashësia për muret perimetrale është 20 cm, për këtë objekt ka autorë projekti arkitekt D. B dhe konstruktore N. B”. Këto dy dokumente përcaktojnë qartë se objekti ka qenë brenda parametrave të qëndrueshmërisë konstruktive, referuar akt-ekspertizës së sipërpërmendur, çka jep të dhëna për llojin e konstruksionit të godinës, si dhe parametrat teknikë përkatës.

- 1.4.12 Më tej Komisioni, bazuar në dy dokumentet e përmendura më lart, duke përcaktuar sipërfaqen dhe koston mesatare të ndërtimit për metër katror të viteve kur janë ndërtuar katet e banesës sipas udhëzimeve të Këshillit Ministrave, respektivisht për vitin 2003 dhe 2008 (vendimi 2008 ka shëbyer si bazë për llogaritjen e kateve shtesë ndërtuar në vitin 2009), kreu analizë të koston së ndërtimit me qëllim që të vlerësonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte pasur të ardhura nga burime të ligjshme për ndërtimin e godinës 5-katëshe.
- 1.4.13 Analiza e koston së ndërtimit, referuar kostove mesatare të çmimeve të ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave (EKB), respektivisht për çdo periudhë të ndërtimit si më lart, të deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlera e secilit kat rezultoi si më poshtë:
- i. Sipas udhëzimi nr. 1, datë 08.05.2003, të kostove mesatare të ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave, për katin përdhe, të parë dhe të dytë, me sipërfaqe ndërtimi 465.2 m², periudhë ndërtimi tetor 2003 me çmim mesatar për metër katror 22.615 lekë, kostoja e ndërtimit është 10.520.498 lekë (sipërfaqja 465.2 m² X 22.615 lekë/m²).
 - ii. Sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.08.2008³, të kostove mesatare të ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave, për shtesë kati mbi ndërtesë, respektivisht kati i tretë dhe i katërt, me sipërfaqe ndërtimi 277.8 m², periudhë ndërtimi gjashtëmuji i parë i vitit 2009 (me çmim mesatar për metër katror 27.439 lekë), kostoja e ndërtimit është 7.622.554 lekë (sipërfaqe 277.8 m² X 27.439 lekë/m²).
 - iii. Referuar të dy llogaritjeve me lart, respektivisht 10.520.498 lekë për katin përdhe, të parë dhe të dytë + (plus) 7.622.554 lekë për katin e tretë dhe të katërt, kostoja mesatare e ndërtimit për të gjithë godinën 5-katëshe është 18.143.052 lekë në total.
- 1.4.14 Diferenca midis koston së ndërtimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” në shumën 3.100.000 lekë dhe koston mesatare të ndërtimit sipas EKB-së, në shumën 18.143.052 lekë, është e konsiderueshme.
- 1.4.15 Bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë të investimit/ndërtimit të banesës 5-katëshe.
- 1.4.16 Në lidhje me koston e ndërtimit, subjekti të rivlerësimit pretendon se: “...e gjithë kostoja e investimit e llogaritur i atribuohet subjektit pa marrë parasysh faktin se ajo banesë është në pronësinë e tij dhe të vëllait, B. Rr...”. Komisionin vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi subjekti i rivlerësimit nuk solli prova për të vërtetuar bashkëpronësinë me vëllain B. Rr. Subjekti i rivlerësimit e ka pranuar dhe vetë, gjatë shpjegimeve përfundimtare, se ai ishte pronari dhe poseduesi i këtij objekti *de jure*.
- 1.4.17 Për sa i përket raport-vlerësimit të datës 16.07.2018, përgatitur nga studio “***”, me administrator inxhinier P. H dhe inxhinier R. Sh për koston e ndërtimit të godinës 5-katëshe, porositur nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni konkludon se ai nuk mund të merret parasysh, pasi ai ka trajtuar vetëm llogaritjen e punimeve sipërfaqësore. Sipas inxhinierëve, ata nuk kanë pasur në dispozicion një sërë të dhënash konstruktive të punimeve të fshehta, të cilat do të provonin vlerën reale të investuar në këtë godinë.
- 1.4.18 Në lidhje me koston e ndërtimit të godinës 5-katëshe, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se kostoja e ndërtimit të godinës 5-katëshe është

³ Udhëzimi i Këshillit Ministrave të vitit 2008 ka shëbyer si bazë për llogaritjen e kateve shtesë ndërtuar në vitin 2009, për shkak se nuk kishte dalë akoma udhëzimi i viti 2009.

3.100.000 lekë, siç deklarohet në deklaratën e vitit 2003 dhe atë të vitit 2009. Por as që kostoja e ndërtimit është 5.900.000 lekë, sipas deklarimeve të subjektit në mars 2018⁴.

1.4.19 Si përfundim, për sa më lart arsyetuan, Komisioni konkludon se kostoja e ndërtimit për të gjithë godinën 5-katëshe është 18.143.052 lekë në total.

Në lidhje me burimin e ligjshëm për ndërtimin e godinës së banimit 5-katëshe

1.4.20 Nga analiza mbi burimin financiar që ka shërbyer për ndërtimin e godinës 5-katëshe, duke e ndarë në dy pjesë (i) kati përdhe, i parë dhe i dytë (që nga subjekti janë deklaruar se janë ndërtuar një herë në vitin 2003, një herë në 2004), dhe (ii) kati i tretë dhe i katërt (ndërtuar në vitin 2009 sipas deklarimeve të subjektit), rezulton si vijon:

1.4.21 **Lidhur me ndërtimin e katit përdhe, të parë dhe të dytë, në vitin 2003 - 2004, deklaruar si i ndërtuar me të ardhurat nga emigracioni në Greqi** në shumën prej 2.8 milionë lekësh, subjekti i rivlerësimit shpjegoi dhe paraqiti bashkëlidhur si prova këto dokumente: i) leja e punës e lëshuar nga autoritetet policore greke; ii) pasaporta e tij e vjetër me nr. ***, lëshuar më datë 09.01.1998, ku pasqyrohet kthimi ose hyrja në Shqipëri nga shteti grek më datë 12.10.1998; iii) vërtetimi i datës 22.01.2016 i lëshuar nga "Raiffesien Bank" sh.a., sipas të cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit kishte çelur një depozitë kursimi në ish-Bankën e Kursimeve më datë 23.10.1998 me nr. depozite ***, me afat tremujor, në shumën 1.600.000 (një milion gjashtëqind mijë) lekë, si dhe 1.2 milion lekë që subjekti shpjegoi se i kishte mbajtur në shtëpi deri në vitin 2000 kur ishte blerë trualli.

1.4.22 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e të ardhurave nga puna me dokumentacion justifikues ligjor, pra që të ketë qenë në marrëdhënie pune, por ai me anë të provave që dërgoi provoi vetëm që ka qenë në Greqi, duke pretenduar se ka punuar. Nga ana tjetër, ai provoi se kishte shumën prej 1.600.000 lekësh në bankë, pa vërtetuar me dokumentacion ligjor burimin e tyre. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se këto para vinin nga emigracioni.

1.4.23 Bazuar në sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se me anë të shpjegimeve të dhëna dhe provave të dërguara, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Më tej, ai nuk arriti të provojë burimin e krijimit (nëse ka qenë i punësuar) të të ardhurave dhe përderisa nuk provoi burimin, subjekti i rivlerësimit nuk arriti as të provonte ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, ku specifikohet se: "*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...*".

1.4.24 **Në lidhje me të ardhurat nga "CRS Albania" në shumën prej 1.660.000 lekësh**, si burim tjetër që ka shërbyer për ndërtimin e shtëpisë 5-katëshe sipas subjektit, Komisioni pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, i konsideron ato si burim për efekt të llogaritjes së të ardhurave deri në vitin 2003.

1.4.25 **Në lidhje me burimin tjetër të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, atë të kredisë prej 18.000 eurosh, marrë në "NBG Bank"**, Komisioni arrin në përfundimin se ky burim krijimi nuk u arrit të shpjegohej bindshëm për arsye se: (i) në nenin 1 të kontratës së kredisë thuhet se: "Qëllimi i kredisë është blerja e një apartamenti me adresë në Rr. "****" Tiranë; ndërsa (ii) referuar përgjigjeve të pyetësorit mars 2018, në lidhje me marrjen dhe destinacionin e shumës së marrë kredi, subjekti deklaroi se: "... marrja e kredisë prej 18 mijë eurosh është bërë me qëllimin e përdorimit të saj në godinën 5-katëshe në ndërtim. Një pjesë e kësaj kredie është përdorur për disa detyrime të prapambetura gjatë ndërtimit të

⁴ Sipas subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e tij dërguar me e-mail në mars 2018, vëllai i tij, B. Rr, ka kontribuar në shumën 1.600.000 - 1.800.000 lekë për pjesën e ndërtimit të bërë në vitin 2004 dhe rreth 900.000-1.000.000 lekë në vitin 2009.

shtëpisë, kryesisht për çimento, hekur dhe tulla, si dhe punime të tilla, si suvatime të jashtme. Pjesa më e madhe e kësaj kredie (me përfaqësi 10 mijë euro) është përdorur për punimet që janë kryer në katin përdhës, për ndarjen e këtij kati në katër ambiente garsoniere me qëllim përgatitjen e tyre për dhënie me qira (punime të tilla si ndarje muresh të brendshme, shtrime, suvatime, dyer dhe dritare, si dhe katër banjave të vogla, nga një për çdo garsoniere)...”.

1.4.26 Sidoqoftë, për efekt të analizës financiare, kjo është marrë si burim për ndërtimin e shtëpisë 5- katëshe dhe është analizuar nga ana e Komisionit. Por edhe duke konsideruar kredinë e marrë si burim për ndërtim, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar ndërtimin e shtëpisë.

Në lidhje me mjaftueshmërinë financiare të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e godinës 5-katëshe

1.4.27 Duke marrë në konsideratë koston mesatare të ndërtimit të godinës 5-katëshe në shumën 18.143.052 lekë dhe analizimin e burimeve të krijimit më lart, si dhe analizën financiare të kryer për këtë qëllim, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur, si dhe personat e tjerë të lidhur, nuk kanë mjaftueshëm të ardhura nga burime të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtëpisë 5-katëshe, për këto arsye:

1.4.28 Në lidhje me të ardhurat e vitit 2003 (fillimi i ndërtimit të shtëpisë), për fillimin e ndërtimit të katit përdhës, të parë dhe të dytë, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, vëllai B. Rr, rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme, në shumën prej 9.812.108 lekësh.

1.4.29 Treguesit financiarë për vitin 2003, duke shtuar të ardhurat e mbartura të subjektit të rivlerësimit dhe të vëllait B. Rr deri më 31.12.2003, pagesën për blerjen e truallit, treguesit financiarë deri në vitin 2003 (pa përfshirë shpenzimet jetike, të shkollimit, shëndetit etj., për periudhën deri më 31.12.2002), paraqiten si më poshtë:

Shpenzime & pagesa		Të ardhura & ndryshim likuiditetesh	
Përshkrimi	Vlera në lek	Përshkrimi	Vlera në lek
Shpenzime, kosto ndërtimi sipas Udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2003	10520498	Të ardhura neto nga paga në 2003	186.954
Pagesë bl. trualli 2000	800000	Të ardhura neto nga paga “CRS”	1.848.263
Shpenzime mobilimi (pyetësori)	180000	Të ardhura neto nga Shkolla e Magjistraturës	591.020
Shpenzime jetese në vit	1137500	Të ardhurat e vëllait me vërtetim deri më 31.12.2003	499.653
		Ndryshim likuiditeti gj. (01.01.1998-31.12.2003)	-300.000
TOTAL	12637998	TOTAL	2.825.890
Shpenzime dhe pagesa të pajustificuara nga të ardhurat			-9.812.108

1.4.30 Në lidhje me të ardhurat e krijuara në vitin 2009 (ndërtimi i shtesës, kati i tretë dhe i katërt), subjekti ka deklaruar se është ndërtuar kati tretë dhe i katërt dhe ky ndërtim ka kushtuar 600.000 lekë, nga të ardhurat e tij dhe të familjes (deklaruar në deklarin periodik të vitit 2009), ndërkohë që në përgjigjet të pyetësorit datë 08.03.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kontribut financiar për ndërtimin e katit të tretë dhe të katërt ka dhënë dhe vëllai i tij, B. Rr, në një vlerë prej 900.000 -1.000.000 lekësh. Për të vërtetuar të ardhurat e të vëllait, B. Rr, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa dokumente, të cilat nuk u morën në konsideratë nga ana e Komisionit për këto arsye:

- i. ka deklarime kontradiktore në lidhje me kohën e punës në emigracion Greqi (korrik 1997-shtator 1999, sipas përgjigjeve të pyetësorit nr. 2), dhe dokumentacionit të dërguar për të

ardhurat e realizuara (është paraqitur vetëm një kontratë pune e datës 05.06.2001, për të cilën shuma e të ardhurave dhe kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës janë të paqarta);

- ii. vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër me të ardhurat neto të të vëllait B. Rr për periudhën gusht 2002 - qershor 2004, në vlerë 758.241 lekë, nuk përmbante elementet bazë të ekstremiteteve të një dokumenti shkresor, si data apo numri i shkresës, për këtë arsye nuk mund të merret si provë me vlerë të plotë.

- 1.4.31 Por, nga analiza tërësore e dokumentacionit ligjor provues të subjekti të rivlerësimit dhe personave të lidhur dhe referencave ligjore për kostot mesatare të ndërtimit të banesave të vitit 2009, rezulton se mungojnë të ardhura nga burime të ligjshme financiare në shumën 8.112.751 lekë për subjektin e rivlerësimit, siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Analizë financiare/ Viti 2009

Shpenzime & pagesa		Të ardhura & ndryshim likuiditetesh	
Përshkrimi	Vlera në lek	Përshkrimi	Vlera në lek
Shpenzime, kosto ndërtimi	7.622.554	Të ardhura neto nga paga	1.556.888
Pagese kësti kredie	296.614	Ndryshim likuiditet gj. (01.01.2009-31.12.2009)	- 1.100.471
Shpenzime jetese në vit	650.000		
TOTAL	8.569.168	TOTAL	456.417
Shpenzime dhe pagesa të pajustificuara nga të ardhurat			-8.112.751

- 1.4.32 **Për sa i përket burimit të të ardhurave nga qiraja e katit përdhe në vitin 2009**, që kanë kontribuar në ndërtimin e katit të tretë dhe të katërt, për efekt të analizës financiare është marrë në konsideratë shkresa e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, e cila konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimet mbi të ardhurat nga qiradhënia për vitin 2009. Ky konfirmim nuk ndryshon rezultatin e analizës financiare për vitin 2009 lidhur me ndërtimin e katit të tretë dhe të katërt, por e nxjerr subjektin e rivlerësimit me mungesë të të ardhurave në shumën prej -7.572.751 lekësh, siç paraqitet në tabelën më poshtë:

Analizë financiare/Viti 2009 pas shkresës së sipërcituar të DRT-së Tiranë për qiradhënien

Shpenzime & pagesa		Të ardhura & ndryshim likuiditetesh	
Përshkrimi	Vlera në lek	Përshkrimi	Vlera në lek
Shpenzime, kosto ndërtimi	7.622.554	Të ardhura neto paga	1.556.888
Pagesë kësti kredie	296.614	Të ardhura neto qira, shk. nr. ***prot., datë 12.07.2018	540.000
Shpenzime jetese në vit	650.000	Ndryshim likuiditeti gj. (01.01.2009-31.12.2009)	-1.100.471
TOTAL	8.569.168	TOTAL	996.417
Shpenzime dhe pagesa të pajustificuara nga të ardhurat			-757.2751

- 1.4.33 Nga sa më lart, rezulton se edhe sikur t'i marrim të mirëqena kostot e deklaruara nga subjekti, por të paprovuara me dokumentacion, del qartë se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për ndërtimin e godinës 5-katëshe.

- 1.4.34 Për efekt të procesit të rivlerësimit, të ardhura e ligjshme janë përcaktuar në pikën 3 të nenit D të Kushtetutës, që përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij*

ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”.

Në lidhje me kredinë e marrë prej 18.000 eurosh nga “NBG Bank”

1.4.35 Komisionit i rezulton se në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi pranë bankës “NBG” dhe në vitin 2011 rezulton se ka shlyer 15.500 euro. Nga analizimi i pagesës së këseteve të kredisë, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për shlyerjen e kësaj kredie në vitin 2011, siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Analizë financiare/ Viti 2011 në lidhje me shlyerjen e kredisë

Shpenzime & pagesa		Të ardhura & ndryshim likuiditetesh	
Përshkrimi	Vlera në lek	Përshkrimi	Vlera në lek
Pagesë këst apartamenti	1.250.000	Të ardhura neto paga, shpërblime	2.050.220
Pagesë këst kredie	2.153.415	Te ardhura nga qira neto	720.000
Shpenzime të tjera	480.368	Ndryshim likuiditeti gj. (01.01.2011-31.12.2011)	1.213.468
Shpenzime jetese në vit	650.000		
TOTAL	4.533.783	TOTAL	3.983.688
Shpenzime dhe pagesa të pajustificuara nga të ardhurat			-550.095

1.4.36 Përveç sa më lart analizuam, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur deklarime kontradiktore në dokumente të ndryshme në lidhje me fillimin e ndërtimit të shtëpisë, si fakt i rëndësishëm për të analizuar aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit rezulton se: (i) **në vetëdeklarimin për legalizim**, të datës 21.03.2005, subjekti ka deklaruar që ndërtimi i përket muajit tetor të vitit 2003, ndërsa (ii) **në deklaratën e vitit 2004**, në seksionin pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar “*Shtëpi private banimi dy kate (në proces legalizimi), me vlerë 2.500.000 lekë*”, krijimi i saj është gjatë 2004, ndërsa (iii) **në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike**, në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar nga ana e Komisionit (përgjigjeve të pyetjes 11), në lidhje me shumën e arredimit të banesës, subjekti ka deklaruar se: *...arredimi i shtëpisë është bërë gjatë viteve 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007, ndërsa* (iv) **në përgjigjet e pyetësorit të datës 8.03.2018** ka deklaruar se: “*Fillimi i punimeve për ndërtimin e shtëpisë e kam deklaruar në muajin janar 2004 dhe punimet kanë vazhduar deri në muajin qershor të vitit 2004, ku janë ndërtuar kati përdhes, kati i parë dhe kati i dytë ...*”.

1.4.37 Pra, Komisioni arrin në konkluzionin se ka mospërputhje në deklaratimet e subjekti të rivlerësimit në deklaratat vjetore, “Vetting”, pyetësor dhe dokumentacionin depozituar në procesin e vetëdeklarimit për legalizim, me qëllim fshehjen e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e katit përdhe dhe të dytë të godinës 5-katëshe.

1.4.38 **Për sa i përket burimit të krijimit të katit të tretë dhe të katërt**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është ndërtuar gjatë vitit 2009 me vlerë prej 600.000 lekësh, pa cilësuar burimin e krijimit, ndërsa në vitin 2009 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të katit të tretë “*kontributin financiar personal dhe të familjes (vëllezërve)*”, ndërsa në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, ka deklaruar se ka likuiditete 300.000 lekë, ndërsa në deklaratën vjetore të vitit 2004 ka deklaruar se ka ndërtuar një shtëpi private 2-katëshe në vlerën 2.500.000 lekë, pa përcaktuar burimin e krijimit, si dhe ka deklaruar marrjen e kredisë më datë 15.04.2004 nga “NBG Bank” në shumën 18.000 euro.

1.4.39 Më tej, Komisioni arrin në konkluzionin se për burimin e krijimit të katit të tretë dhe të katërt të kësaj godine 5-katëshe ka deklarim të rremë dhe kontradiktor, pasi (i) në deklaratën periodike të vitit 2009, ka deklaruar si burim krijimi kontributin financiar personal dhe të

familjes pa përcaktuar ndonjë shumë, ndërsa (ii) në përgjigje të pyetësorit të datës 08.03.2018, ka deklaruar se “*si burim krijimi ka shërbyer kontributi i vëllait në shumën prej 900.000 -1.000.000 lekësh*”, ndërsa (iii) në deklaratën “Vetting” të 2017-ës nuk deklaroi asnjë shumë si burim krijimi.

1.4.40 Në lidhje me akt-ekspertimin e dërguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 25.07.2018, me objekt “Llogaritjen e të gjitha pasurive të akumuluar ndë vite, detyrimet financiare, burimet dhe origjina e pasurisë së subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare”, të hartuar më datë 20.07.2018 nga shoqëria audituese “***”, Komisioni nuk e pranon për arsye të mëposhtme:

- i. kostot e ndërtimit të banesës që janë marrë në konsideratë u janë referuar vetëm deklarimeve të subjektit dhe nuk janë bazuar në asnjë dokument ligjor dhe ekonomik provues;
- ii. nuk janë marrë në konsideratë deklarimi përpara fillimit të detyrës dhe deklarimet periodike pranë ILDKPKI-së, në veçanti vlerat monetare *cash* dhe në bankë. Sipas akt-vlerësimit më datë 31.12.2003 subjekti ka likuiditete të lira në shumën 4.663.893 lekë, ndërsa sipas deklarimit përpara fillimit të detyrës, dorëzuar më datë 25.03.2004, subjekti i rivlerësimit deklaroi likuiditete *cash* më datë 31.12.2003 në vlerë 300.000 lekë;
- iii. dokumentacioni nuk ishte i plotë dhe i referuar në prova, si dhe kishte gabime materiale të konstatuara në hedhjen dhe llogaritjen e të dhënave, që e bëjnë këtë akt të paplotë dhe jo të saktë.

2. Për gjendjen e llogarisë rrjedhëse pranë “BKT”-së në vlerë 1.990.000 lekë

Burimi i krijimit:

- i. Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2016, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, me shtetasen N. Xh, blerë me anë të kredisë së butë.
- ii. Kredi, e cila është përfituar nga “BKT”-ja për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 97.8 m², në ***, Tiranë, në shumën 6.250.000 lekë, bazuar në VKM-në nr. 600.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- i. *Statement*-in bankar nga Banka Kombëtare Tregtare (“BKT”) për gjendjen e llogarisë në shumën 1.990.665 lekë.
- ii. Kreditimin e llogarisë në shumën 4.626.805 lekë, datë 22.11.2016, nga noterja A. M për shitje pasurie.
- iii. Kreditimin e llogarisë në shumën 2.391.315 lekë, datë 13.12.2016, nga noterja A. M për shitje pasurie.

Lidhur me burimin, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- iv. Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2016, për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 97.8 m² në ***, Tiranë, në shumën 6.900.000 lekë. Sipas kontratës, shuma 4.565.000 lekë është likuiduar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2016, dhe pjesa e mbetur, 2.335.000 lekë, janë depozituar në numrin e llogarisë në “BKT”.
- v. Kontratë nr. *** rep., nr. ***kol., datë 21.11.2016.

2.1 Faktet nga hetimi administrativ

2.1.1 Subjekti i rivlerësimit ka gjendje të llogarisë rrjedhëse pranë “BKT”-së në vlerë 1.990.000 lekë, krijuar nga kontrata e shitjes së pasurisë apartament me sipërfaqe 97.8 m², ***, Tiranë.

- 2.1.2 Ky apartament rezulton i blerë fillimisht nga subjekti i rivlerësimit nga shtetasi H. Rr, me anë të kontratës së shitjes paraprake nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2011, me vlerë 6.250.000 lekë, nga e cila 5.000.000 lekë do të shlyhej me kredi bankare në “BKT” gjatë vitit 2012, ndërsa pjesa tjetër prej 1.250.000 lekësh i është shlyer shitësit jashtë zyrës noteriale.
- 2.1.3 Në këtë kontratë gjithashtu është vendosur kushti se shuma 5.000.000 lekë do të shlyhet nga blerësi te shitësi, deri në datën 07.12.2011, me lëvrimin e kredisë bankare nga “BKT”, ndërkohë që kontrata e kredisë bankare është marrë më datë 09.03.2012, ndërsa shuma është lëvruar më datë 12.03.2012.
- 2.1.4 Në lidhje me kredinë e marrë, rezulton se ajo është kredi me kushte lehtësuese sipas kontratës së kredisë bankare nr. *** rep., nr. ***kol., datë 09.03.2012, nga “BKT”-ja, e cila lidhet mbi bazën ligjore të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”...”.
- 2.1.5 Në dokumentacionin e depozituar nga ana e subjektit të rivlerësimit për të përfituar këtë kredi me kushte lehtësuese, subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar se nuk disponon pasuri të paluajtshme (banesë) në vendin ku ushtron detyrën, si dhe nuk dispononte pasuri me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim. Këto deklarime përbënin shkaqet për përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese.
- 2.1.6 Në të njëjtën kohë që subjekti i rivlerësimit kërkonte të përfitonte një kredi me kushte lehtësuese, rezulton se ai posedonte banesën 5-katëshe, në Rr. “****”, në Tiranë, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim.
- 2.1.7 Gjithashtu rezulton se marrja e kredisë me kushte lehtësuese nga ana e subjektit të rivlerësimit është konstatuar si shkelje nga ana e grupit të auditimit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, pasi në legjislacionin përkatës nuk parashikohet përfitimi për kreditë nga prokurorët e rretheve, pozicion i mbartur nga subjekti Dritan Rreshka në momentin e përfitimit të saj.
- 2.1.8 Pas konstatimit të shkeljes nga ana e grupit të auditimit, subjekti i rivlerësimit shet apartamentin me sipërfaqe 97.8 m² në ***, Tiranë, me anë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2016, në shumën 6.900.000 lekë, me blerës N. Xh, bashkëshortja e H. Rr (shitësit), dhe nga kjo shitje, shuma prej 4.565.000 lekësh është likuiduar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2016 dhe pjesa e mbetur, 2.335.000 lekë, janë depozituar në numrin e llogarisë në “BKT”.

2.2 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimit të të ardhurave, administroi provat si më poshtë:

- 2.2.1 Deklarimet e kryera nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur së bashku me dokumentacionin justifikues përkatës pranë ILDKPKI-së, si subjekte deklarimi, dërguar nga ana e ILDKPKI-së me anë të shkresës nr. *** prot., datë 17.11.2017.
- 2.2.2 Raportin e arsyetuar nga ana e ILDKPKI-së në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërguar në Komision me shkresës nr. *** prot., datë 17.11.2017.
- 2.2.3 Dokumente që vërtetojnë gjendjen e llogarisë pranë BKT-së në shumën prej 1.990.515 lekësh, datë 27.1.2017, dërguar pranë Komisionit nga ana e BKT-së me shkresën nr. *** prot., datë 10.01.2018.
- 2.2.4 Dokumentet që vërtetojnë shitjen e pasurisë ⁵.

⁵ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2016, për apartamentin e banimit në *** me palë shitëse subjektin Dritan Rreshka dhe dhënëse pëlqimi bashkëshortja, S. Rr dhe palë blerëse N. Xh. Ndërsa me shkresën nr. ***, datë 16.08.2017, ZQRPP konfirmon pasurinë nr. ***, ZK ***, vol. ***, fq. ***, apartament me sipërfaqe 97.8 m², ***, Tiranë, në emër të G. K. T, me datë regjistrimi 03.06.2017, me shënimin kontratë dhurimi, dërguar në Komision, me shkresën nr. *** prot., datë 05.01.2018.

- 2.2.5 Dokumente që provojnë se subjekti i rivlerësimit ka marrë një kredi të butë sipas VKM-së nr. 600 të Këshillit të Ministrave⁶.
- 2.2.6 Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2011, midis H. Rr si shitës dhe Dritan Rreshkës si blerës.
- 2.2.7 Dokumente që vërtetojnë se shtetasi Dritan Rreshka, kredinë e marrë në vitin 2012 e ka likuiduar në muajin dhjetor 2016, sipas shkresës me nr. ***prot., datë 13.09.2017, dërguar pranë ILDKPKI-së nga EKB.
- 2.2.8 Dokumente që vërtetojnë pozicionin e mbartur nga subjekti, z. Dritan Rreshka, në momentin e përfitimit të kredisë së butë.

2.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dërguar deri më datë 25.07.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

- 2.3.1 Arsyet pse ka kërkuar të marrë një kredi me kushte lehtësuese kanë qenë për shkak të nevojës që ka pasur për t'u larguar nga shtëpia private së bashku me bashkëshorten dhe dy fëmijët për shkak të disa konflikteve të brendshme mes familjarëve të tij prej disa vitesh. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ka dhënë me qira katin e tyre respektiv që të largoheshim nga aty dhe të blinin një apartament tjetër për të jetuar.
- 2.3.2 Më tej, ai shpjegon se duke qenë se apartamenti që subjekti do të porosiste nuk ishte i ndërtuar, por do të ndërtohej në të ardhmen dhe ai nuk kishte asnjë pronë të regjistruar për të garantuar kredinë, atëherë u është kërkuar ortakëve të firmës nga ana e bankës që ata të dilnin dorëzanës ndaj subjektit për të garantuar kthimin e kredisë.
- 2.3.3 Sipas subjektit, pagesa referuar edhe shkresës së datës 05.10.2011, të nënshkruar nga ortakët e shoqërisë "MGB" drejtuar "BKT"-së rezulton se është marrë përsipër të mbulohet prej dy ortakëve, nisur nga rrethanat e krijuara dhe subjekti nuk ka pranuar të shlyente gjithë pagesën e kontratës për një objekt që do të ndërtohej pas tri vitesh.
- 2.3.4 Subjekti shpjegoi se pagesa e këtij detyrimi është bërë nëpërmjet bankës dhe është deklaruar pranë ILDKPKI-së, konkretisht:
- i. në deklaratën periodike të vitit 2014, ku është pasqyruar pagesa e shumës prej 700.000 mijë lekësh së bashku me dokumentin bankar të pagesës; si edhe
 - ii. në deklaratën periodike të vitit 2015, ku është pasqyruar pagesa e shumës prej 500.000 lekësh së bashku me dokumentin bankar të depozituar pranë ILDKPKI-së;
 - iii. shuma e mbetur prej 50.000 mijë lekësh është deklaruar në formularin e deklarimit të pasurisë për vitin 2016 (kopje të deklaratave të printuara nga disku i ILDKPKI-së, faqet 701, 713 dhe 725)
 - iv. shuma prej 1.250.000 lekësh për blerjen e apartamentit ndaj ortakut të shoqërisë "MGB", deklaruar kjo në deklaratat periodike që ai ka depozituar pranë ILDKPKI-së për vitin 2012 dhe 2013 (deklaratat e printuara nga disku i ILDKPKI-së, faqet 675 dhe 679 bashkëngjitur);
- 2.3.5 Në lidhje me kushtet për përfitimin e kredisë së butë, subjekti shpjegoi se sikundër është e qartë, subjektet përfituese nuk duhet të kishin pasuri të luajtshme, përfshirë likuiditetet në vlerë më të madhe se vlera e shumës për kreditim, që do të thotë pasuri të luajtshme mbi 5 milionë lekë dhe se ai nuk ka pasur pasuri të luajtshme me vlerë më të lartë se kjo shumë në kohën që ka aplikuar për kredi;

⁶ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. ***kol., datë 09.03.2012, nga Banka Kombëtare Tregtare, e cila lidhet mbi bazën ligjore sipas nenit 1, pika 1.1, "Palët kanë rënë dakord që në bazë të nenit 1031 e në vazhdim, të nenit 560 e në vazhdim të Kodit Civil, të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane", të ndryshuar, VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007 "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë"...", për të blerë një apartament me sipërfaqe 97.8 m² i ndodhur në ***, Tiranë, dërguar në Komision me anë të shkresës *** prot., datë 10.01.2018, nga Banka Kombëtare Tregtare.

- 2.3.6 Lidhur me faktin se subjekti ka pasur një ndërtesë pesëkatëshe në disponim, ai sqaron se:
- i. *kjo ndërtesë ishte një ndërtesë informale, e palegalizuar dhe e paregjistruar në Hipotekë, ndërtesë e cila dhe mund të mos legalizohej në përfundim të procesit, dhe*
 - ii. *ajo nuk ishte një ndërtesë e përbashkët me vëllain.*
- 2.3.7 Më tej, ai shpjegon se mënyra se si e ka lexuar dhe kuptuar dispozitën ai dhe personat që e kanë miratuar kredinë e tij, ka qenë që bëhej fjalë për pasuri të paluajtshme në pronësi dhe të regjistruara pranë ZVRPP-së Tiranë, sipas përcaktimeve të Kodit Civil, pjesës së fitimit të pronësisë dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- 2.3.8 Sipas subjektit të rivlerësimit, në asnjë rast në shkresën drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave nuk bëhet fjalë për shkëlqje të kryer nga ana e prokurorëve përfitues dhe as nga ana e tij dhe në asnjë rast kredia që ai ka përfituar nuk është ndryshuar nga kredi e lehtësuar në kredi tregtare deri në kthimin përfundimtar të saj në dhjetor të vitit 2016.
- 2.3.9 Në lidhje me kredinë, subjekti shpjegoi se arsyeja se përse është ndërprerë marrëdhënia e kredisë, si dhe i është kthyer mbrapsht apartamenti ortakut tjetër të shoqërisë “****” ka qenë pikërisht fakti se nga ana e këtyre personave nuk është realizuar ndërtimi që ata kishin detyrimin të realizonin brenda tre vjetësh, sipas lejes së ndërtimit *** të KRRT-së, komuna ***, me nr. ***, datë 27.09.2011.
- 2.3.10 Për më tepër, ai shpjegon se me kalimin e kohës së përcaktuar, është informuar se afati i lejes së ndërtimit kishte përfunduar dhe ata nuk po mundeshin ta rinovonin atë. Në këto kushte ka kërkuar nga përfaqësuesit e shoqërisë që ta ndërprishte marrëdhënien me ta dhe se donte të bënte shitjen e apartamentit dhe të shlyente kredinë, pasi vazhdimi i saj ishte humbje ekonomike për subjektin.

2.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- 2.4.1 Referuar fakteve të dala nga hetimi administrativ, provave të administruara dhe shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i rezulton se:

Në lidhje me blerjen dhe shitjen e apartamentit me sip. 97.8 m², *, Tiranë**

- 2.4.2 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me këtë shtëpi, pasi:
- i. Në deklaramin periodik vjetor 2011 dhe 2012 ka deklaruar si shitës shoqërinë “****” sh.p.k, ndërsa sipas kontratës shitës është z. H. Rr, që rezulton një nga ortakët e “****” sh.p.k .
 - ii. Shuma prej 1.250.000 lekësh, sipas kontratës së shitjes është shlyer me nënshkrimin e saj nga palët në vitin 2011, ndërsa në deklaramat e vitit 2012 dhe 2013, subjekti e deklaroi si borxh ndaj shoqërisë së ndërtimit.
 - iii. Për të njëjtën shumë, gjatë shpjegimeve përfundimtare, subjekti e deklaroi se këtë borxh të tij e ka shlyer shoqëria “****” sh.p.k. në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa ai e ka shlyer në vitin 2014.
- 2.4.3 Subjekti, në lidhje me këtë pagesë të shumës prej 1.250.000 lekësh pretendon se kjo pagesë sipas shkresës së datës 05.10.2011 të nënshkruar nga ortakët e subjektit “****” sh.p.k., drejtuar “BKT”-së rezulton se është marrë përsipër të mbulohet prej dy ortakëve, nisur nga rrethanat e krijuara dhe se ai nuk ka pranuar të shlyejë të gjithë pagesën e kontratës për një objekt që do të ndërtohej pas tri vitesh.
- 2.4.4 Komisioni çmon se shkresa e nënshkruar nga ana e ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 05.10.2011, nuk provon thëniet e subjektit të rivlerësimit, pasi deklarimi nga ana e ortakëve, se do ta marrin përsipër pagesën, nuk vërteton ekzekutimin e pagesës dhe nuk konsiderohet si dokumnetacion ligjor provues. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë provë

shkresore për të provuar pretendimin e tij se kishte kundërshtuar pagesën e shumës 1.250 000 lekë në momentin e firmosjes së kontratës.

- 2.4.5 Nga sa më lart arsyetuar, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për likuidimin e shumës 1.250.000 lekë në vitin 2011, në momentin kur është firmosur kontrata, siç përshkruhet në tabelë më poshtë:

Analizë financiare Viti 2011

Shpenzime & pagesa		Të ardhura & ndryshim likuiditetesh	
Përshkrimi	Vlera në lekë	Përshkrimi	Vlera në lekë
Pagesë këst apartamenti	1.250.000	Të ardhura neto paga, shpërblime	20.502.20
Pagesë këst kredie	2.153.415	Të ardhura nga qira	720.000
Shpenzime të tjera	480.368	Ndryshim likuiditet gj. (01.01.2011- 31.12.2011)	1.213.468
Shpenzime jetese në vit	650.000		
TOTAL	4.533.783	TOTAL	3.983.688
Shpenzime dhe pagesa të pajustificuara nga të ardhurat			-550.095

- 2.4.6 Më tej, Komisionit i rezulton se veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me firmosjen e kontratave të blerjes së apartamentit me sip. 97.8 m², ***, Tiranë, në vitin 2011 dhe të shitjes së këtij apartamenti në vitin 2016 janë veprime fiktive/të simuluar dhe në mashtrim të ligjit, për arsye se:

- i. Ato nuk kanë pasur si qëllim që të krijojnë pasojë juridike sipas kontratës, shfaqjen e ligjshme të vullnetit të palëve, sipas nenit nën 79 të Kodit Civil, i cili specifikon se: *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”*. Për pasojë, këto kontrata janë të pavlefshme.
- ii. Ka deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me shitësin, ku një herë deklaron se e ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., ndërsa kontratën e ka firmosur me z. H. Rr si një person fizik.
- iii. Kontratën e shitjes në vitin 2016 e ka nënshkruar me z. N. Xh e cila, siç pranon dhe vetë subjekti, është bashkëshortja e ortakut tjetër të shoqërisë “****” sh.p.k., pra apartamenti i është kthyer mbrapsht së njëjtës shoqëri.
- iv. Në thëniet e tij përfundimtare deklaron se leja e ndërtimit nuk është ekzekutuar asnjëherë, kur në fakt bashkëlidhur dokumentacionit të kredisë lehtësuese, paraqet foto të apartamentit si pjesë integrale e aplikimit për kredi.
- v. Sipas kontratës së blerjes në 2011, specifikon se shuma prej 1.250.000 lekësh i është shlyer në momentin e firmosjes së kontratës personit fizik z. H. Rr, ndërsa në shpjegimet e tij përfundimtare subjekti thotë se i është shlyer shoqërisë “****” sh.p.k.

- 2.4.7 Si rrjedhojë, këto kontrata të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë të pavlefshme, pasi me anë të këtyre kontratave nuk ka qenë qëllimi që subjekti të posedonte këtë pronë, por që të përfitonte kredi me kushte lehtësuese.

- 2.4.8 **Në lidhje me kredinë lehtësuese të marrë nga subjekti i rivlerësimit**, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në rrethin e personave përfitues, sipas VKM-së nr. 600 të Këshillit Ministrave.

- 2.4.9 Në të njëjtë kohë ai ka kryer deklarin të rremë nën përgjegjësinë e tij, duke deklaruar se nuk ka poseduar asnjë pronë të paluajtshme në vendin e ushtrimit të detyrës, në Tiranë, si dhe nuk dispononte pasuri me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim (*deklarime, të cilat përbënin shkaqet për përfitim të kësaj kredie me kushte lehtësuese*).
- 2.4.10 Komisionit i rezultoi se në momentin e transferimit të kredisë, në emër të subjektit është lëshuar një leje legalizimi, që vërteton se ai posedon dhe ka në pronësi një godinë 5-katëshe. Kjo provon se subjekti i rivlerësimit, në fakt, posedonte një pronë të paluajtshme në vendin e ushtrimit të detyrës. Ky deklarin i subjektit të rivlerësimit bie në kundërshtim me pikën 5 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar), i cili përcakton se: *“Me nevojën për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, sipas këtij vendimi, do të nënkuptojmë rastin kur subjekti nuk disponon ose disponon më pak sipërfaqe banimi se kuota minimale”*.
- 2.4.11 Nga sa arsyetohet më lart, Komisionit i rezultoi se qëllimi i marrjes së kredisë me kushte lehtësuese është përfitimi i padrejtë i shumës prej 5.000.000 lekësh, nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe jo blerja e apartamentit, i cili edhe nuk ishte materializuar siç shprehet dhe subjekti i rivlerësimit.
- 2.4.12 Referuar nenit 79 të Kodit Civil, i cili parashikon se: *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”*, si dhe Vendimit Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 932, datë 22.06.2000, që shprehet se: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezultoi prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”*, veprimet juridike për blerjen e apartamentit dhe marrjen e kredisë janë veprime juridike fiktive.
- 2.4.13 Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për të marrë kredinë me kushte lehtësuese janë fiktive dhe në shkelje të ligjit. Për më tepër, këto veprime nuk janë në përputhje figurën e një prokurori në detyrë, duke cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

3. Blerje obligacione në tregun primar pranë “BKT”, datë 21.10.2015 dhe 17.2.2016, me vlerë 7.900.000 lekë. Burimi i të ardhurave: i) nga punësimi si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë; ii) nga puna si ekspert, pedagog; iii) nga qiraja; dhe iv) interesa të mëparshme bankare.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën “Vetting”:

- i. Vërtetim për blerje obligacioni në tregun primar, datë 21.10.2015, në shumën 5.900.000 lekë.
- ii. Njoftim debitimi, datë 22.9.2015, në shumën 5.424.000 lekë, nga “RFB” për kalimin e shumës në llogari personale pranë “BKT”-së.
- iii. Njoftim debitimi, datë 30.03.2015, nga “RFB”, për shumën 5.313.500 lekë, me klient përfitues “Raiffeisen Prestige” dhe “Fibank”.
- iv. *Statement* bankar, datë 24.01.2017, nga “RFB”, për transaksione prej vitit 2010.
- v. *Statement* bankar, datë 25.10.2016, nga “BKT”-ja, ku pasqyrohen transaksionet e shumës për obligacione në shumën 5.424.000 lekë, transferuar nga “RFB”, datë 22.09.2015, shtuar me shumën 500.000 lekë, datë 09.10.2015 dhe në total shuma 5.900.000 lekë.

- vi. Kontratë depozite bankare nga “BKT”-ja për depozitë me afat të shumës 2.100.000 lekë, datë 17.02.2015, me afat maturimi deri më datë 17.02.2016.
- vii. *Statement* bankar/transferim nga llogaria në llogari nga “BKT”-së për debitimin e llogarisë në shumën 2.300.000 lekë dhe kalimin në obligacione.

3.1 Faktet nga hetimi administrativ

- 3.1.1 Subjekti i rivlerësimit ka blerë obligacione në tregun primar pranë “BKT”-së, më datë 21.10.2015 dhe 17.2.2016, me vlerë 7.900.000 lekë me burim krijimi të ardhurat nga qiraja e ambienteve të godinës 5-katëshe.
- 3.1.2 Subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar si të ardhura nga qiraja për periudhën 2009 - 2015 shumën prej 4.800.000 lekësh bruto, shumë e cila ka shërbyer si bazë për krijimin e depozitave pranë “Raiffeisen Bank” dhe më tej për blerjen e obligacioneve.
- 3.1.3 Nga këto të ardhura të deklaruara, Komisionit i rezultoi se subjekti ka paguar tatimin mbi qiranë për shumën bruto prej 2.800.000 lekësh, sipas ligjit, ndërsa për shumën e mbetur prej 2.000.000 lekësh, Komisioni vërtetoi se deri më datë 08.01.2017 (*kohë kur ka dorëzuar deklaratën “Vetting” 2017*), subjekti i rivlerësimit nuk kishte paguar tatimin mbi qiranë.

3.2 Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike, private dhe mori deklarime të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

- 3.2.1 Deklarimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së dhe Komisionit.
- 3.2.2 Dokument që vërteton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer pagesën e tatimit mbi qiratë për vitin 2009, 2010 dhe 2012, dërguar pranë Komisionit, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 22.02.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë .
- 3.2.3 Deklarimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.
- 3.2.4 Dokumente që vërtetojnë se subjekti i rivlerësimit ka blerë obligacione në tregun primar pranë “BKT”-së, dërguar nga “BKT”.
- 3.2.5 Dokument që vërteton se burimi i krijimit të blerjes së obligacioneve ka qenë depozita e krijuar në “Raiffeisen Bank” nga të ardhurat nga qiraja në vitin 2009, 2010 dhe 2012, sipas shkresës së dërguar nga “Raiffeisen Bank”.
- 3.2.6 Deklarimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike.

3.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të dërguara deri më datë 25.07.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, dërgoi një shkresë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, ku vërtetonte se kishte paguar detyrimet tatimore edhe për vitin 2009, 2010 dhe 2012.

3.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- 3.4.1 Referuar fakteve të dala nga hetimi administrativ, provave për vërtetimin e këtyre fakteve, si dhe provave që sollti subjekti, Komisioni del në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare nga të ardhura të ligjshme për blerjen e këtyre obligacioneve, për shkak se:
 - i. ky detyrim nuk ishte i paguar para datës së dorëzimit të deklaratës “Vetting” 2017;
 - ii. në deklaratën “Vetting” por as në deklaratat periodike të viteve 2009, 2010 dhe 2012 nuk janë reflektuar se subjekti i rivlerësimit ka paguar taksat;

iii. nga dokumentacioni i depozituar, rezulton se subjekti i ka paguar këto taksa në vitin 2018.

3.4.2 Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se të ardhurat në shumën prej 2.000.000 lekësh nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi rezultoi e provuar gjatë hetimit se subjekti i rivlerësimit nuk kishte paguar tatimin mbi qiranë për vitet 2009, 2010 dhe 2012, sipas parashikimeve të Kushtetutës.

3.4.3 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se këto të ardhura nuk janë të ligjshme për qëllimet e ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi qiratë. Ky konkluzion bazohet në nenin D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*.

4. Pasuri të padeklaruar në deklaratën “Vetting”, por që u zbuluan gjatë hetimit administrativ

4/A Ortakëria/pronësia mbi aksionet e shoqërisë “**” sh.p.k., me NIPT ***, që i përket personave të tjerë të lidhur, respektivisht z. S. Rr dhe znj. A. Rr.**

4.1 Faktet nga hetimi administrativ

4.1.1 Subjekti i rivlerësimit i ka dhuruar vëllait tij, z. B. Rr, dy apartamente në godinën 5-katëshe, një apartament në vitin 2012 dhe një apartament në vitin 2017;

4.1.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vëllai i tij, z. B. Rr, ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë në vlerën 1.800.000 lekë për ndërtimin e shtëpisë, pra ai është bashkëpronar;

4.1.3 Subjekti ka përdorur disa herë makinë, të regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k;

4.1.4 Z. S. Rr dhe znj. A. Rr (bashkëshortja e z. B. Rr) në janar të vitit 2014 kanë blerë 100 % kuotat e shoqërisë “****” sh.p.k. nga ortaku I. B. Sipas kontratës së shitjes së kuotave të datës 13.01.2014, nr. ***dhe nr. ***, janë blerë përkatësisht 51% të kuotave të shoqërisë në vlerë 51.000 lekë nga shtetasja A. Rr, si dhe 49 % të kuotave nga shtetasi S. Rr.

4.1.5 Referuar pasqyrave financiare (dhe shënimet shpjeguese respektive) të kësaj shoqërie në vitin 2016, znj. A. Rr dhe z. S. Rr kanë deklaruar se shoqëria ka një detyrim ndaj këtyre, në cilësinë e ortakëve të shoqërisë, në shumën **prej 46.951.037 lekësh**, edhe pse konstatohet se shoqëria nuk ka shpërndarë dividendë (ndarje fitimi) për periudhën 2014 (kur është blerë shoqëria) deri 2016.

4.1.6 Fitimi neto i shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 01.01.2014 - 31.12.2016 ka qenë në shumën 3.293.580 lekë.

4.1.7 Në detyrime afatgjata të vitit 2016 në vlerë 76.382.448 lekë, janë deklaruar nga shoqëria : - tituj të huamarrjes afatgjatë në vlerë 29.431.411 lekë; dhe - detyrime të tjera të pagueshme në vlerë **46.951.037 lekë** (e cilësuar ortakë).

4.2 Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike, private dhe mori deklarime të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

4.2.1 Deklarimin periodik të vitit 2010 bërë pranë ILDKPKI-së, se vëllezërit kanë kontribuar në ndërtimin e godinës 5-katëshe, me vlerë financiare 600.000 lekë.

4.2.2 Deklarimet e subjekti të rivlerësimit me anë të postës elektronike, si dhe në shpjegimet përfundimtare se vëllai B. Rr ka kontribuar financiarisht në shumën 2.800.000 lekë për ndërtimin e shtëpisë 5-katëshe.

- 4.2.3 Dokumente që vërtetojnë se znj. A. Rr, bashkëshortja e z. B. Rr, si dhe z. S. Rr, vëllai i z. Dritan Rreshka, kanë blerë 100 % kuotat e shoqërisë “****” sh.p.k., më datë 13.01.2014, dërguar pranë Komisionit nga QKB-ja.
- 4.2.4 Dokumente që vërtetojnë se shoqëria i detyrohet znj. A. Rr dhe z. S. Rr në cilësinë e ortakëve të shoqërisë në shumën prej 46.951.037 lekësh (më datë 31.12.2016), sipas pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese të vitit 2016, dërguar pranë Komisionit nga QKB-ja dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan.
- 4.2.5 Dokumente që vërtetojnë se fitimi neto i shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 01.01.2014 - 31.12.2016, ka qenë në vlerën 3.293.580 lekë, dërguar pranë Komisionit nga QKB-ja dhe shkresa nr. 4449/1 prot., datë 30.04.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan.
- 4.2.6 Dokumente që vërtetojnë se subjekti i rivlerësimit i ka dhuruar bashkëshortit të znj. A. Rr 2 apartamente në godinë 5-katëshe, të ndodhur në Rr. “****”, dërguar pranë Komisionit nga ZVRPP-ja Tiranë.
- 4.2.7 Deklarimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetjeve drejtuar më datë 08.03.2018, si dhe shpjegimeve përfundimtare dhënë deri më datë 26.07.2018, si dhe ato në seancë dëgjimore, se z. B. Rr ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë në vlerën 1.800.000 lekë për ndërtimin e shtëpisë, pra ai është bashkëpronar.
- 4.2.8 Deklarimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetjeve të drejuara më datë 08.03.2018, se ka përdorur disa herë makinën në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.

4.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të dërguara deri më datë 25.07.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

Shuma prej 46.951.037 lekësh, (ku në shënimet shpjeguese në krah të rubrikës “Detyrim ortaku” në bilanc, është shënuar llogaria “455”), nuk ka të bëjë me detyrime të shoqërisë ndaj ortakëve aktualë të saj, S. dhe A. Rr, dhe as borxh të dhënë nga ana e tyre shoqërisë. Kjo shumë përfaqëson llogarinë “467”, detyrime të shoqërisë ndaj kreditorëve në shumën 28.912.256 lekë të mbartura nga viti 2013 dhe shuma prej 18.038.781 lekësh përfaqëson detyrime të krijuara pas kësaj periudhe, të cilat presin radhën e likuidimit.

4.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- 4.4.1 Referuar nenit 3 të pikës 14 të ligjit nr. 84/2016 “*Persona të tjerë të lidhur*” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, pasi kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit.
- 4.4.2 Bazuar në referencën ligjore më lart, Komisioni arrin në konkluzionin se z. S. Rr dhe znj. A. Rr (bashkëshortja e vëllait tjetër z. B. Rr), ortakë në shoqërisë “****” sh.p.k. janë persona të tjerë të lidhur, për shkak se:
- i. subjekti i rivlerësimit pas legalizimit të godinës 5-katëshe i ka dhuruar vëllait të tij, z. B. Rr (bashkëshortit të znj. A. Rr) 2 apartamente, duke lënë të kuptohet se ai është bashkëpronar, pasi kishte kontribuar financiarisht në shumën prej 2.800.000 lekësh;
 - ii. subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e vitit 2010 se për ndërtimin e katit të 3 dhe 4 kanë kontribuar vëllezërit, pra B. dhe S., duke nënkuptuar se ata janë bashkëpronar në këtë godinë 5-katëshe;
 - iii. subjekti i rivlerësimit ka përdorur disa herë makinën, e cila është në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., sipas deklarimeve të bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit.
- 4.4.3 Duke qenë në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, z. S. Rr dhe znj. A. Rr, Komisioni hetoi mundësitë financiare të tyre si administratorë të shoqërisë “****” sh.p.k., duke analizuar

pasqyrat financiare të shoqërisë. Nga ky hetim u vërtetua se ortakët S. dhe A. Rr i kanë dhënë borxh shoqërisë shumë prej 46.951.037 lekësh deri më datë 31.12.2016.

- 4.4.4 Referuar nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këtë marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë*”, por sipas rezultateve dhe provave të Komisionit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk arritën të justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 46.951.037 lekësh, borxh i dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., sipas pasqyrave financiare të vitit 2016, edhe pse e kanë pasur detyrim sipas ligjit të sipërcituar.
- 4.4.5 Pretendimit i subjekti të rivlerësimit, se shuma prej 46.951.037 lekësh nuk ka të bëjë me detyrime të shoqërisë ndaj ortakëve aktualë të saj, S. dhe A. Rr, dhe as me ndonjë borxh të dhënë nga ana e tyre shoqërisë, por përfaqëson llogarinë “467” në pasqyrat financiare të shoqërisë, e emërtuar “detyrime të shoqërisë ndaj kreditorëve në shumën 28.912.256 lekë të mbartura nga viti 2013 dhe vlera prej 18.038.781 lekësh përfaqëson detyrime të krijuara pas kësaj periudhe, të cilat presin radhën e likuidimit, nuk është i bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni, për arsye se:
- 4.4.6 Sipas pasqyrave financiare të vitit 2013, të dorëzuara nga vetë shoqëria, rezulton që detyrimet e shoqërisë ndaj ortakëve (kreditorëve) janë në vlerën 14.000.000 lekë deri më datë 31.12.2013 dhe jo 28.912.256 lekë, siç shpjegon subjekti i rivlerësimit.
- 4.4.7 Më tej, sipas pasqyrave financiare të viteve 2014, 2015 dhe 2016, respektivisht në shënimet shpjeguese të tyre, detyrimet e krijuara pas vitit 2013 janë respektivisht në vlerën 28.912.256 lekë për vitin 2014, në vlerën 28.912.256 lekë për vitin 2015 dhe për vitin 2016 Komisionit i rezulton se në zërin e pasqyrave “Detyrime afatgjata të tjera të pagueshme ortakë” gjendja deri në dhjetor të këtij viti është 46.951.037 lekë. Pra, sipas pasqyrave financiare për këto vite, detyrimet e krijuara pas periudhës 2013, nuk janë në shumën 18.038.781 lekë, siç shprehet subjekti i rivlerësimit, por në shumën 32.951.037 lekë (që rezulton nga 46.951.037 lekë - 14.000.000 lekë), siç dhe përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

Zërat e pasqyrave financiare	Gjendja dt. 31.12.2013	Gjendja dt. 31.12.2014	Gjendja dt. 31.12.2015	Gjendja dt. 31.12.2016
Pasive afatshkurtra, detyrime ortakë(455)	14.000.000	28.912.256	28.912.256	
Det. afatgjata të tjera të pagueshme ortakë (455)				46.951.037

- 4.4.8 Si konkluzion, Komisioni del në përfundimin se z. S. Rr dhe znj. A. Rr, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, nuk justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 32.951.037 lekësh, dhënë borxh shoqërisë “****” sh.p.k., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

4/B Depozita në shumën prej 3.885.914 lekësh në emër të shtetasës Xh. Rr, nënës së subjektit të rivlerësimit/ person tjetër i lidhur, pranë “Raiffeisen Bank”.

4.5 Faktet nga hetimi administrativ:

- 4.5.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009 shtesë kati mbi ndërtesën aktuale të banimit, e ndërtuar me kontributin financiar personal dhe të familjes.
- 4.5.2 Personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. Xh. Rr ka një llogari bankare në “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 3.885.914 lekësh.
- 4.5.3 Më datë 03.09.2008, në llogarinë në “Raiffeisen Bank” (nr. ***), znj. Xh. Rr ka derdhur shumën 1.191.000 lekë (pa përmendur burim të të ardhurave).
- 4.5.4 Llogaria depozitë në euro, në emër të znj. Xh. Rr, është hapur me një derdhje në vlerë 10.000 euro, më datë 28.02.2007. Nuk ka derdhje periodike, por e njëjta shumë është rivendosur disa

herë në depozitë me afat dhe janë tërhequr më datë 03.09.2008 shuma 3424 euro dhe më datë 04.09.2008 shuma 6720 euro (nuk dihet burimi i të ardhurave fillestare në 2007).

- 4.5.5 Referuar lëvizjeve bankare, nëna e subjektit ka shtuar vlerat e derdhjeve në “Raiffeisen Bank”, konkretisht në mars 2009 shton shumën 640.000 lekë dhe më datë 31.08.2009 ka derdhje nga babai, z. M. Rr, në vlerën 1.320.000 lekë (me përshkrimin të ardhura nga emigracioni), shuma e depozitimeve për 2009 është 1.960.000 lekë.

4.6 Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike, private dhe mori deklarime të vetë subjektit me anë të postës elektronike si më poshtë:

- 4.6.1 Deklarimin periodik të vitit 2010, të bërë pranë ILDKPKI-së nga subjekti i rivlerësimit.
- 4.6.2 Dokumente që vërtetojnë të ardhurat e nënës dhe babit të subjektit të rivlerësimit, dërguar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, nr. *** prot., datë 06.04.2018.
- 4.6.3 Dokumentacioni justifikues i dërguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 26.07.2018.

4.7 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të dërguara deri më datë 25.07.2018 , si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, shpjegoi se:

Llogaria bankare pranë “Raiffesien Bank” e personit të lidhur/nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. Xh. Rr, në shumën 3.885.914 lekë, e ka burimin nga të ardhurat e krijuara ndër vite nga të dy prindërit e subjektit të rivlerësimit, znj. Xh. dhe z. M. Rr, të cilët jetojnë të ndarë nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, në Librazhd.

4.8 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- 4.8.1 Znj. Xh. Rr, nëna e subjektit të rivlerësimit, rezulton të jetë mbajtësi i vetëm i kësaj llogarie bankare. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbledhur nga institucionet publike dhe private, Komisionit i rezulton se personi tjetër i lidhur nuk ka të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të krijuar këtë depozitë në shumën 3.885.914 lekë, detyrim ky që rrjedh nga parashikimet e nenit 32, pika 4, i cili përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këtë marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë.”*
- 4.8.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se pas daljes në pension të parakohshëm të babait të tij, z. M. Rr, ai ka emigruar në Greqi në vitet 1997 deri në vitin 2002, ku ka punuar në periudha të ndryshme sezonale (punësim sipas sezoneve në ndërtim dhe bujqësi) dhe ka realizuar të ardhura në vende të tilla si Katerinë, Zakynthos etj. dhe të ardhurat e krijuara nga kjo periudhë punësimi sipas shpjegimeve të dhëna nga babai janë mbi 3.000.000 lekë, - Komisioni çmon se ky pretendim nuk qëndron pasi subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë bindshëm të ardhurat e marra nga emigracioni me dokumentacion ligjor justifikues, sipas parashikimeve të nenit D të pikës 3 të Aneksit të Kushtetutës.
- 4.8.3 Edhe për sa i përket dokumentacionit që provon të ardhurat nga puna të nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. Xh. Rr, Komisioni, pasi kreu një analizë ekonomike në lidhje me këto të ardhura, del në konkluzionin se të ardhurat e përfituara nga ana e znj. Xh. Rr nuk mjaftojnë për të krijuar këtë depozitë.
- 4.8.4 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion që justifikon vërtetësinë e shpjegimeve të tij, për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij likuiditeti.

5. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR I PROCESIT DHE PROCEDURËS SË RIVLERËSIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. DRITAN RRESHKA

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet, rrethanat që Komisioni disponon për vlerësimin e pasurisë:

5.1 Në lidhje me pasurinë nr. 1, katin përdhe dhe të dytë të një shtëpie private, ndodhur në Rr. “*” /***, Tiranë,** bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie të legalizuar më datë 20.02.2012, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në mars 2012; nuk provoi burimin e të ardhurave nga emigracioni dhe qiraja e katit përdhes të kësaj prone dhe nuk provoi me dokumentacion ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë: (1) fillimin e punimeve të ndërtimit në deklaratën para fillimit të detyrës të viti 2003; (2) dy kate ndërtim (i tretë dhe i katërt) në deklarinim vjetor të vitit 2012; (3) legalizimin e ndërtimit të godinës 5-katëshe në deklarinim e vitit 2012; (4) dhurimin e apartamentit me sip. 166.2 m² vëllait të tij, z. B. Rr.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për këtë aset, për shkak se: (1) ka bërë deklarinim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin; (2) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar koston e ndërtimit, shfrytëzimit dhe mobilimit të kësaj pasurie respektivisht në vitet 2003 - 2004 nga emigracioni në Greqi dhe 2009 nga qiraja e katit përdhes; (3) ka kryer fshehje të kësaj pasurie në deklarinimet vjetore; (4) ka kryer deklarinim të rremë të vlerës së ndërtimit të kësaj godine; (5) ka mospërputhje të deklarimeve midis deklaratës vjetore 2009 dhe deklaratës “Vetting” në lidhje me kontributin financiar që ka shërbyer për shtesën e katit të tretë dhe të katërt; si dhe ka mospërputhje në lidhje me datën e fillimit të punimeve të kësaj godine.

5.2 Për gjendjen e llogarisë rrjedhëse pranë “BKT”-së në vlerë 1.990.000 lekë, dhe më konkretisht (1) kontratën e blerjes dhe të shitjes së apartamentit me sip. 97.8 m², *, Tiranë dhe (2) kredinë me kushte lehtësuese të përfituar nga “BKT”-ja në vlerë 5.000.000 lekë,** bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe ligjin e zbatueshëm, në lidhje me burimet e krijimit të kësaj llogarie rrjedhëse, Komisioni arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të rremë në lidhje me shitësin e apartamentit me sip. 97.8 m², në ***, Tiranë, dhe ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për likuidimin e shumës 1.250.000 lekë, në dhjetor të vitit 2011, për blerjen e këtij apartamenti, sipas kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti (kontratë e cila ka shërbyer si burim për krijimin e gjendjes së llogarisë).
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi lehtësuese në shumën 5.000.000 lekë, në mënyrë të padrejtë, duke mos qenë në rrethin e personave përfitues, referuar VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të rremë dhe fiktiv në lidhje faktin se nuk posedonte asnjë pronë të paluajtshme në vendin e ushtrimit të detyrës, Tiranë, si dhe nuk dispononte pasuri me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim, referuar kontratës së kredisë me “BKT”-në (kredia që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 97.8 m², në ***, Tiranë, i cili është shitur në vitin 2016).

5.3 Në lidhje me blerjen e obligacioneve në tregun primar pranë “BKT”-së, datë 21.10.2015 dhe 17.2.2016, me vlerë 7.900.000 lekë, bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe në ligjin e zbatueshëm, në lidhje me burimet e blerjes së këtyre obligacioneve, Komisioni arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga qiraja e katit përdhes për shkak se nuk kishte paguar detyrimet tatimore të të ardhurave nga qiraja për vitet 2009, 2010 dhe 2012, respektivisht për shumën prej 2.000.000 lekësh.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë llogari për shkak se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e një pjese të obligacioneve në shumën 2.000.000 lekë

5.4 Në lidhje me pronësinë mbi aksionet e shoqërisë “**” sh.p.k., me NIPT ***, të personave të tjerë të lidhur, z. S. Rr dhe znj. A. Rr,** bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe në ligjin e zbatueshëm, në lidhje me mjaftueshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e vlerës prej 32.951.037 lekësh dhënë borxh shoqërisë, Komisioni arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të shumës prej 32.951.037 lekësh, që personat e lidhur, znj. A. Rr dhe z. S. Rr, i kanë dhënë borxh shoqërisë “****” sh.p.k., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

5.5 Depozita në shumën prej 3.885.914 lekësh, në emër të shtetasës Xh. Rr, nëna e subjektit të rivlerësimit/ person tjetër i lidhur, pranë “Raiffeisen Bank”

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të shumës prej **3.885.914 lekësh.** vendosur në depozitë nga ana e personit tjetër të lidhur, nënës së subjekti, znj. Xh. Rr, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni D, Ç dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar

si dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 31.07.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Xhensila PINE

Anëtare

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Anisa DUKA

Sekretare gjyqësore